



REPUBIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS  
MUNICIPALITY OF KLINA  
OPŠTINA KLINA



[www.komuna-klina.org](http://www.komuna-klina.org)

Komuna e Klinës

Kuvendi i Komunës

01Nr. 06-33757 2023

Klinë, 25.09.2023

## PROCESVERBAL

Nga mbledhja e Kuvendit të Komunës së Klinës, mbajtur me datë 28. 07. 2023, në sallën e Kuvendit, nisur nga ora 10:00.

Pjesëmarrës në mbledhje: Kryetari i Komunës, Anëtarët e Kuvendit të Komunës, drejtorët e Drejtorive, përfaqësues të policisë së Kosovës, përfaqësues të OSBE, Mediat lokale si dhe qytetarë.

Mbledhjen e hapi Kryesuesi i Kuvendit, z. Fadil Gashi i cili përshëndeti të gjithë të pranishmit në sallë. Në fillim të mbledhjes kryesuesi Gashi kërkoi që me një minutë nderim të kujtojnë punëtorën e ndjerë të administratës së Komunës, Sevdije Ismaili e cila ndërroi jetë para disa ditëve.

U konstatua se në mbledhje marrin pjesë 25 anëtarë të Kuvendit dhe se mungon znj. Blerina Gashi me arsye, ka rast vdekje në familje. Si dhe Ndrec Zefaj pritët të i bashkohet mbledhjes. z. Fadil Gashi, kryesues, tha se para se të fillojmë me rendin e ditës ai ka një letër konfirmim për dorëheqje të z. Shemsedin Berisha të cilin e falënderoj për kontributin e dhënë. Ndërsa në vend të z. Berisha, anëtare e re e kuvendit do të jetë znj. Lonora Jaha-Daka. Më pastaj u lexua vendimi i KQZ dhe u dha betimi nga znj. Leonora Jaha- Daka.

Për Rendin e ditës kërkohet të i shtohet një pikë shtesë nga drejtoria e Financave-shtimi i buxhetit dhe krijimi i kodit të ri për sera. Kërkohet që të përmirësohet një shumë që ka diferencën prej 120 eurove nga vendimi i kaluar i kuvendit.

Për Rendin e Ditës fjalën e morri z. Esat Raci. I cili edhe në këtë seancë kërkoi që dikush nga komisioni i formuar për hetimin e procedurave për dhënien e pëlqimeve dhe lejeve për fabrikën e cementit të vijë dhe të raportoj në Kuvend. Dhe sa i përket

kërkesës nga drejtoria e Financave janë dakord me shpresën se nuk do të ketë shkelje flagrante si në vitin 2022 sa i përket ndarjes së serave.

z. Zafer Gashi, kërkoi që të vendose në rendin e ditës Kërkesa për zëvendësimin e anëtarëve të komisionit dhe të merr një epilog përmes votimit.

z. Arben Limanaj shprehu shqetësimin e grupit të LDK-së në lidhje me rastet tragjike që po ndodhin mbi rrugën hekurudhore. Kërkojnë nga komuna që të bëhet apel për marrjen e masave mbrojtëse.

Kryesuesi tha se sa i përket komisionit për hetimin e dhënieve të lejeve, nëse ata duan pavarësisht se nuk e ka vullnetin kryetari i komisionit, të tjerët janë shumicë dhe mund ta përfundojnë punën dhe të raportojnë. Kryesuesi tha se mos raportimi i kryetarit të komisionit është përgjegjësi penale e tij. Ndërsa sa i përket procedimit në kuvend të kërkesës për zëvendësimin e anëtarëve të komisionit, po ka mundësi që të procedojmë pasi që të përfundojnë pikat e rendit të ditës.

Me pikën shtesë të propozuar nga kryesuesi, rendi i ditës me 25 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUA.

Pika 1 e Rendit të Ditës: Arsyetimi i mungesave

Mungon me arsye znj. Blerina Gashi- Berisha të cilës i ka vdekur prindi.

Pika 2 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

z. Lirie Gashi: Përshëndetje. Duke kërkuar mirëkuptimin e procesmbajtësit dua të them se fjala ime në lidhje me mëditjet që nuk i kemi marrë për Komisionin e emërimit të rrugëve dhe gabim është shkruar në proces- për pjesëmarrje në komitet.

Me 26 vota për asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUA procesverbali.

Pika 3 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i Rekomandimeve të KPF.

Kryesuesi tha se përveç një kërkesë që është adresuar tek drejtoria e Kadastrit dhe zyrën ligjore, gjitha kërkesat e tjera janë në rendin e ditës.

Në lidhje me rekomandimin për zyrën e kadastrit dhe atë ligjore, z. Zafer Gashi kishte dilema se sa do të krijon efekte dhe është orientuar mirë. Ai propozoi që të rishikohet edhe një herë ky rekomandim.

Me 25 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUAN

Pika 4 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi i raportit të menaxhimit financiar për periudhën janar-qershor 2023.

z. Enver Berisha, drejtor i FEZH: Përshëndetje të gjithëve. Ashtu siç e sheh ligji për financat publike jemi të detyruar që të raportojmë para juve çdo tre mujor. Raporti për periudhën janar-qershor 2023 është përgatitur në pajtim me dispozitat e nenit 45, paragrafët 45.2, 45.4 dhe 46.1 të Ligjit nr. 03/L – 048, për menaxhimin e financave

publike dhe përgjegjësitë. Raporti i përgatitur paraqet buxhetin në SIMFK, shpenzimet dhe arkëtimin e të hyrave .

Raport financiar për buxhetin, të hyrat dhe shpenzimet për periudhën janar-qershor 2023 është punuar për të analizuar realizimin e buxhetit në periudhën janar-qershor 2023. Buxheti sipas SIMFK për vitin 2023 duke përfshirë edhe të hyrat nga granatet e brendshme dhe të jashtme është 14,508,039.98 €, buxheti për këtë periudhë është më i lart për 15.52% se buxheti i vitit 2022. Granti Qeveritar është burimi kryesor i financimit të buxhetit komunal, ku pjesëmarrja është 80.49% në vitin 2023. Buxheti nga të hyrat vetanake të komunës për vitin 2023 është shuma prej 1,373,774.00 €. Buxheti nga THV të bartura të vitit 2022 gjatë periudhës janar-qershor 2023 është shuma prej 976,793.04 €. Granti i donatorëve të brendshëm - Participimi i qytetarëve në shumën prej 31,332.12 €, në raport me vitin paraprak buxheti nga ky grand është 18.49 %. Grante tjera të jashtme - Donacion i jashtëm në shumën prej 18,341.33 €, Granti i performancës në total është shuma prej 776,403.11 €, Shpenzimet buxhetore në periudhën janar-qershor 2023 në shumën prej 5,940,563.13€ krahasuar me shpenzimet për periudhën e njëjtë të vitit 2022 në shumën prej 4,520,502.62 € janë më të larta për 31.41 % .Buxheti i shpenzuar në periudhën janar-qershor 2023 në shumën prej 5,940,563.13€ është 40.95 % e buxhetit në SIMFK krahasuar me vlerën e përgjithshme të buthtuar për vitin 2023. Nga Granti qeveritar janë shpenzuar 5,622,491.61 € (48.15 % në raport me buxhetin nga Granti ), nga të hyrat vetanake 2023 janë shpenzuar 93,756.66 € (6.82% në raport me buxhetin nga Granti ), nga të hyrat e bartura 222,228.19 € (22.75% në raport me buxhetin nga Granti), nga donacioni jashtëm – Save The Children 2086.67€ (64.42% në raport me buxhetin nga donacioni ). Ndërsa nga totali i buxhetit të shpenzuar në këtë periudhë në shumën prej 5,940,563.13€ nga granti qeveritar janë shpenzuar 94.65% . Shpenzimet në periudhën janar-qershor 2023 në shumën prej 5,940,563.13€ krahasuar me shpenzimet për periudhën e njëjtë të vitit 2022 në shumën prej 4,520,502.62 € janë më të larta për 31.41 % . Shpenzimet për paga dhe mëditje krahasuar me vitin paraprak janë më të larta për 14.26%, shpenzimet për mallra dhe shërbime janë më të larta për 36%, shpenzimet për shërbime komunale janë më të larta për 67.98 %, shpenzimet për subvencione janë më të larta për 13.15 % dhe shpenzimet kapitale janë më të larta për 130.98 % .Për shpenzimet nëpër kategori unë nuk po ndalem konkretisht, ju i keni para vetës ato shënime dhe ne këtu jemi nëse dikush ka nevojë për sqarime.

z. Zafer Gashi: Më ka pëlqyer ky raport sidomos ndarja që i është bërë nëpër muaj, është i mirë dhe real. Por kur jemi tek të hyrat krahasuar me vitin 2022 ka një ulje të konsiderueshme në disa kode. Ajo që është më shqetësuese është participimi në shëndetësi që është ulur. Nuk ka të dhëna të sigurt që mjekët dhe infermierët kanë paguar bazuar në këto shifra që janë dhënë në këtë raport. Mirëmbajtja e shkollave është një rritje e arsyeshme, sigurimi i ndërtesave, cilat ndërtesa? Mirëmbajtja e mobileve , shpenzimet për këtë nuk e kuptoj sikurse nuk e kuptoj çka është mirëmbajtja

rutinore. Ndoshta nuk janë të specifikuara në detaje. Megjithëqë këtë ju kisha lutë që të vazhdoni të punoni me përkushtim për një performancë më të mirë.

z. Enver Berisha, drejtor i FEZH: Faleminderit i nderuar Zafer. Ne si drejtori e financave ashtu siç i pranojmë shpenzimet nga dikastere të tjerë ashtu i prezantojmë para juve argumentuar me fakte se nga kanë shkuar këto shpenzime. Tek drejtorja e shëndetësisë, drejtori është këtu dhe do të ju jap sqarime.

z. Agron Bacaj, drejtor i Shëndetësisë: z. Zafer ju jeni profesionist i shëndetësisë dhe duhet ta dini. Në 6 mujorin e parë ka pasur më pak pacientë dhe ka pas më pak participim. Uroj që mos të rritet participimi sepse nuk kam dëshirë që të ketë sëmundje dhe rritje të pacientëve. Anëtarësia e mjekëve paguhet tek oda e mjekëve ndërsa teknikët paguajnë tek oda e infermierëve. Pagesa për anëtarësi bëhet përmes listës së pagave. Ministria e ekzekuton pagesën.

z. Zafer Gashi: Nuk po them që po dezinformon por po jep përgjigje qysh [po të pëlqen. Unë po flas me fjalë të personelit mjekësor të QKMF-së, ata thonë se paguajnë nga xhepi i vet ndërsa ju po thoni që ju ndalet në pagë, këtu diçka nuk është në përputhje.

z. Agron Bacaj, drejtor i Shëndetësisë: Më mirë është me ju besuar fakteve, këtu kam dokumente që tregojnë se transferim bëhet nga gjiro llogaria e mjekëve në xhirollogari të odës së mjekëve.

z. Enver Berisha, drejtor i FEZH: Mbeta borgj një sqarim për z. Gashi. Fjala është për objektet si palestra e sportit, kulmin e shkollës etj, që janë ndërtesa publike që është dashur të intervenojmë në rregullim.

z. Arben Limanaj: Ne si asamblistë mendoj se kemi rol shumë të rëndësishëm evidentimin e këtyre shpenzimeve sidomos të drekave dhe karburanteve dhe kërkojmë që për periudhat e tjera këto shifra të shkojnë në zvogëlim. Shpenzimet kapitale në gjashtë mujorin e parë janë vetëm 22% që nuk tregojnë një performancë të mirë. Mendoj që është shpenzim i vogël dhe s' di sa do të arrihet që të përfitohet grandin i përformancës.

z. Enver Berisha, drejtor i FEZH: Faleminderit z. Limanaj! Duhet ta dimë që Janar dhe Shkurt janë pa buxhet, d.m.th buxheti nuk është i aprovuar në këta muaj prandaj janë vetëm muajt në vijim ku ne mund të bëjmë realizimin e kontratave nga investimet kapitale. Tani jemi tek 30% dhe duke e pasur parasysh se vitin e kaluar kemi qenë edhe më ulët dhe kemi mbërritur kuotën për grandin qeveritar jam i sigurt që deri në fund do të arrijmë edhe tani.

Kryesuesi theksoi se tani në sallë janë 26 anëtarë të kuvendit.

Pika 5 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi i raportit të auditimit të jashtëm për vitin 2022

z. Enver Berisha, drejtor i FEZH: Për çdo vit komunat auditohen nga auditori i jashtëm i cili për tre javë ka qenë prezent në komunën tonë. Si rezultat i kësaj ne kemi marrë një raport që për fat të keq është i kualifikuar. Janë këto lëndë që janë auditu shumë më

herët të viteve 2014 e 2015 dhe që kanë ndikuar që raporti të jetë i kualifikuar. Unë dua të citoj dy rreshta të këtij auditori: Pasqyrat financiare vjetore të komunës së Klinës prezantojnë një punë të drejt dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale në përputhje me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit të sektorit publik sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme. Mbyll citimin. E citova këtë pjesë sepse me gjitha hulumtimet e bëra nga auditori nuk ka gjetur për vitin 2022 asnjë shkelje që ai e ka kualifikuar në këtë raport. Jo elemente të bazuara. Si rezultat i një defekti që nuk është eliminuar në vitin 2006 për disa shtëpia të komunitetit të ndërtuara komuna në vazhdimësi nuk i ka fshi nga pronësia e saj dhe e dyta fabrika e ujit të pijes që është bartur nga komuna në gusht të 2015 si aset i Hidrodrinit dhe nuk është hekur nga pronësia e komunës, janë këto që e kanë bërë këtë raport të kualifikuar. Me shumë përgjegjësi dhe kompetencë e kemi trajtuar këtë raport dhe e them shumë hapur se auditorët nuk kanë qenë krejt serioz dhe të saktë me ne. Ne i kemi dërguar arsyetimet tona por nuk i kanë marrë në konsideratë.

z. Tunë Dedaj: Përshëndetje. E morra me shqetësim këtë raport pasi që nuk e kuptoj ku kanë qenë auditorët në vitin 2014, 2015 që nuk kanë bërë auditim të këtyre gjerave por tani.

z. Esat Raci: Kur e dëgjon Enverin mendon se gjithçka është në rregull. Sipas Enverit gabim janë auditorët, hajde të kërkojmë shkarkimin e tyre. Auditorët e kanë pohuar pikërisht zërin tonë që vazhdimisht e kemi ngritur për shkeljet nga ekzekutivi. Janë 12 rekomandime të auditorit, dhe në çdo rekomandim auditori ju ka bërë pyetje menaxhmentit se a pajtohen. Përveç të pares në të gjitha rekomandimet e tjera menaxhmenti i komunës është pajtuar. Auditori e përmend që nuk janë përfill asnjë kriter tek ndarja e serave, nëse dikush thotë që nuk është ashtu le të urdhëroj ta argumentoj. Të gjitha të gjeturat e auditorit janë me vend.

z. Zafer Gashi: Ajo që për mua është shqetësues është deklarata e drejtorit të financave se këto shkelje janë bartur ndër vite. Si është e mundur që nuk janë përmirësuar nga viti 2017 kur kjo parti e ka pushtetin. Më së shpeshti përsëriten pagesat me vonesë, mos respektimi i afateve ligjore etj. që mund të jenë material për hetim. Shuma të madha nuk janë vlerësuar mirë, klasifikim jo i mirë i shpenzimeve, zotimi i mjeteve pa pranim të faturës, subvencionimi i serave që përveç shkeljeve të kriterëve është bërë edhe ndarje kryesisht partiake. etj.

z. Gashi radhiti edhe shumë shkelje të tjera sipas tij duke thënë në fund që të ju përmbaheni rekomandimeve dhe të përmirësoheni.

Pika 6 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi i planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve të auditorit të jashtëm.

z. Zenun Elezaj, kryetar i Komunës: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit në sallë. Raporti i auditimit është raport që demonstroi progres të jashtëzakonshëm, janë vetëm 5 rekomandime të reja të gjetura që janë simbolike. Përveç opinionit të kualifikuar që nuk jemi aspak të lumtur për këtë, besoj që nuk do të ndikoj në fitimin e grandit për

përformancë. Ne i qasemi çdo shkeljeje, i kemi trajtuar me seriozitet çdo gjetje të auditorit dhe besoj që gjatë këtij viti këto 5 rekomandime të gjetura do të zbatohen plotësisht. Nëse i lexoni të gjeturat e auditimit për ato të gjetura që nuk janë zbatuar, ose kanë nisur të sanohen nuk kanë bazë sepse pothuajse të gjitha janë implementur. Pra, për këtë vit 5 rekomandimet e reja janë paraparë që ti realizojmë gjatë këtij viti gjithsesi.

z. Zafer Gashi: Me të vërtetë është shumë shqetësuese më thënë kryetari i komunës se nuk i beson auditorit. Auditori është një institucion kompetent dhe profesional.

z. Zenun Elezaj, kryetar: Nuk thashë që nuk i besoj por se janë të gjetura simbolike për të cilat ju mund të shihni tendencën e auditorit të jashtëm që merr për bazë elemente të vitit 2006 vetëm që ta bëjë opinion e kualifikuar. Ne nuk kemi mundur të kundërshtojmë sepse situata ka qenë e tillë por do ta përmirësojmë.

z. Fadil Gashi, kryesues: Ky auditor duhet ta sanoj konkluzionin e vet dhe të saktësoj të gjeturat e potencuar sepse në konkluzion të vetin e ka shkruar se sipas mendimit të tyre transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit të komunës së Klinës kanë qenë në të gjitha aspektet materiale në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektet e audituara në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare. Pra të gjeturat nuk përkojnë me konkluzionin e shkruar nga veta ata. Mos të na qet në lajthitje neve sepse unë s'di nga ta pozicionoj vetën tani.

z. Enver Berisha, drejtor i FEZH: Pjesën dërmuese të këtyre rekomandimeve të reja ne qysh tani i kemi implementuar. Ajo që në raport shkuan është tepër simbolike dhe nuk është dashur të jetë as pjesë e raportit. I kemi përfunduar edhe largimin nga pronësia e objekteve të komunitetit dhe jemi në procedurë edhe të fabrikës së ujit. Nuk do të ketë më të gjetura të tilla.

z. Esat Raci: Nëse është simbolike mos plotësimi i asnjë kriteri në ndarjen e serave, nëse është simbolike vonesa e faturave dhe shpenzimet shtesë pa përfill afatet shtesë prej 30 ditëve, atëherë si duket ne nuk po dimë me e lexuar auditorin.

z. Zenun Elezaj, kryetar: Kur them simbolike e kam fjalën për disa gabime procedurale. Shpallej te subvencioneve për OJQ, afati ka qene 15 ditë ndërsa ka përfunduar për 8 ditë. Afati i pagesave gjithashtu, për mendimin tim janë simbolike. Mangësitë evidentohen dhe përmirësohen por jo të gjitha i shoh unë, i sheh auditori i cili me sugjeron dhe normalisht ne e bëjmë planin e veprimit për implementimin e atyre rekomandimeve. Këtë vit sa i përket ndarjes së serave të gjithë ata që kanë aplikuar kanë përfituar.

z. Esat Raci: Nuk e kam plan që të replikoj por dhënia e serave ka qenë puro politike. Tani këtë vit nuk e diji komisioni është në teren dhe do të na bëjë të ditur së shpejti se a i kanë plotësuar kriteret qytetarët që kanë përfituar.

z. Enver Berisha, drejtor i FEZH: Në afate të rregullta nuk ka vonesa në pagesa, vonesat ndodhin vetëm në raste të veçanta kur nuk mund të bëjmë pagesa të cilat mbesin në fund të vitit kalendarik.

z. Tunë Dedaj: Do të doja të dija nëse Esat Raci ka ndonjë emër të një qytetari që ka aplikuar me marr serë që është nga parti tjetër dhe nuk ka marrë serë.

z. Esat Raci: Në vitin 2022 jo një por ka me dhjetëra. Po ashtu edhe në vitin 2023 në thirrjen e parë ka plot ndërsa në thirrjen e dytë jo nuk ka asnjë, të gjithë kanë përfutur pa dallim.

z. Enver Berisha , drejtor i Urbanizimit: Dëshiroj të sqaroj z. Zafer Gashi se me mos nënshkrimin e kontratave nuk fillon fare projekti. Ajo është mos nënshkrimi i planit të menaxhimit që kemi hasur pengesa pasi që ka qenë një sistem i ri i prokurimit. Tani të gjitha bëhen përmes e-prokurimit.

Në lidhje me mos nënshkrimin e planit të menaxhimit që është i evidentuar në të gjeturat e auditorit debati vazhdoj akoma më shumë mes të z. Zafer Gashi dhe drejtorit të urbanizimit.

Pika 7 e Rendi të Ditës: Shqyrtimi i procesverbalit nga takimi i mbajtur i kryetarit të Komunës me qytetarët e Klinës.

Pika 8 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për bartjen e mjeteve nga të hyrat vetanake.

z. Enver Berisha, drejtor i FEZH: Na u deshtë disa herë të përsërisim çështjen e bartjes së mjeteve , na është dashtë të bëjmë disa ndryshime por elementi kryesor ka qenë pagesa për sheshin në qytet. Jemi detyruar që ta ndërrojmë kodin , të krijojmë kod të ri dhe ta sjellim para juve për aprovim. Gjithashtu janë edhe mjetet që duhet ndarë për udhëtimin zyrtar që kuvendi i komunës do ta bëjë në Turqi. E treta është një fond që ne kemi menduar ta krijojmë duke tërheq mjete nga disa projekte dhe të vendoset në drejtorin e administratës për ndryshimin e nxehjes në Komunë. Këto janë arsyet pse është menduar të bëhet kjo bartje.

z. Tunë Dedaj: Ketë që e dëgjova është shumë e mirë. Faleminderit shumë që keni menduar për këto projekte.

Për anulimin e vendimit të parë u votua me 24 vota për asnjë kundër dhe asnjë abstenim dhe për marrjen e vendimit të ri me 24 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUA.

Pika 9 e Rendit të ditës: Rishqyrtim i vendimit 01nr 06 18045/2023 sipas shkresës së Ministrisë së mbrojtjes , planifikimit hapësinor dhe infrastrukturë datë 4. 7. 2023

Kryesuesi tha se duhet anuluar vendimi i marrë nga kuvendi i më hershëm sipas kërkesës së ministrisë në fjalë dhe me 22 vota për asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUA anulimi.

Pika 10 e Rendit të Ditës: kërkesa e LVV për zëvendësimin e anëtarëve të komitetit.

Kryesuesi tha se grupi i LVV mund të marr fjalën dhe të propozoj zgjidhjen e kësaj problematike të nisur nga seanca e kaluar.

z. Zafer Gashi tha se qëndrojnë prapa asaj që kanë kërkuar në seancën e kaluar dhe propozoj që të vendoset në votim zëvendësimi i përfaqësuesve të LVV në dy komitetet.

Kryesuesi kërkoj që të mos shkelet udhëzimi administrativ dhe se të ruhet fryma konstruktive që nuk është prishur asnjëherë këtu e 10 e më shumë vite.

Znj. Valmira Krasniqi: Propozojmë që në komitetin për arsim të zëvendësohet Leonora Ndrecaj me z. Zafer Gashi dhe te komiteti për planifikim urban të zëvendësohet Xhafer Berisha me Valon Dushin.

Znj. Lirie Gashi: Sa i përket komitetit nuk e shoh të arsyeshme të jap dorëheqje. Me e heq një anëtar dhe më fut një anëtar tjetër i bije si fjala popullore "Prish shpi e maro kolibe". Unë nuk dua të kem keqkuptime me asnjë, në komitetin për arsim nuk ka politikë unë jam betuar që të mbroj interesat e qytetarëve. Nëse duhet gjithsesi që subjektit LVV të i takoj kjo pozitë unë me kënaqësi ja jap. Nuk ka asnjë problem.

z. Valmir Bacaj: Propozoj që LVV të vijë me një propozim me shkrim , propozim konkret kë duan ta zëvendësojnë me kë. Kështu është pak telashe sepse ne nuk po e dimë.

Kryesuesi theksoi se në komitetin për arsim në vend të Lirisë LVV propozon Zafer Gashin dhe në vend të Xhafer Berishes propozojnë Valon Dushin.

z. Zafer Gashi: Le të procedohet sipas rregullave të kuvendit. Ne jemi tërhequr dhe jemi pajtuar që në komitetin për emërimin dhe riemërimin e rrugëve të mos ketë ndryshime.

Kryesuesi tha se Liria mbetet anëtare e komisionit për emërim të rrugëve ndërsa zëvendësohet tek komiteti për arsim.

Znj, Lirie Gashi, tha se nuk dëshiron që ti qes në siklet kolegët dhe dëshiron që të ja liroj vendin z. Zafer Gashi.

Me 21 vota për asnjë kundër dhe një abstenim(Tunë Dedaj) U MIRATUA

Tek Komiteti për planifikim urban, ekonomi dhe zhvillim z. Xhafer Berisha propozohet të zëvendësohet me z. Valon Dushi.

Me 22 vota për asnjë kundër dhe asnjë abstenim MIRATOHET.

Pika 11. Propozimi për shtimin e buxhetit dhe krijimin e ri për participim

z. Enver Berisha, drejtor i FEZH: Ky ndryshim ka ardhur si rezultat i numrit më të madh se sa planifikimi për ndarjen e serave. Kontrata kornizë e lejon që të rritet për 10 sera që d.m.th. se në rundin e dyte të ndahen 110 sera.

Kryesuesi tha se duhet anuluar vendimi paraprak dhe të kalohet në vendimin e ri.



Me 22 vota për , asnjë kundër dhe asnjë abstenim U ANULUA vendimi i parë.

Me 22 vota për , asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUA propozimi vendimi i ri.

Pika 12 e Rendit të Ditës: Pyetje dhe përgjigje

z. Asdren Ramadani: Pyetje për z. Marku. Dëshiroj të dijë se çfarë po bëhet për lokalet në pronësi publike që është folur që të vendosen në ankand publik.

z. Besnik Marku, drejtor i Kadastrit: Sa i përket kësaj pyetje, është formuar një komision në lidhje me pronën komunale dhe jemi duke u marr me procedurën e verifikimit ku më pastaj do të dalim me një ankand publik.

Znj. Besiana Gashi: Dua të bëjë një pyetje dhe të paraqes një shqetësim timin. Dua të flas si kryesuese e komitetit për komunitete. Komiteti në fjalë përbehet nga 7 anëtarë ku 4 prej tyre nuk kanë marr mëditje që nga fuqizimi i ligjit të ri të pagave. Për këtë çështje është njoftuar drejtorja përkatëse edhe në mënyrë zyrtare. Kryesuesi gjithashtu është në dijeni dhe edhe pse kanë kaluar 4 muaj nga kjo çështje ne nuk kemi marrë përgjigje konkrete. Dua që këtë përgjigje të na jep drejtori. Çështja e dytë ka të bëjë me neglizhencën e ekzekutivit kur ata ftohen të marrin pjesë në mbledhjet e Komitetit. Për mos ardhjen e tyre në mbledhje të tilla është njoftuar edhe kryesuesi i Kuvendit. Dua të theksoi se janë disa drejtori që përgjigjen vazhdimisht siç është ajo e Shërbimeve publike që gjithmonë është prezent sa herë e thërrasim e po ashtu këtë vit edhe drejtorja e arsimit.

z. Fadil Gashi, kryesues: E them edhe një herë që drejtorët e kanë obligim që të [përgjigjen në ftesat e komiteteve për pjesëmarrje në mbledhje ndërsa sa i përket pagesave të anëtarëve të komitetit në fjalë, nuk është vetëm Klina që është në vështirësi por në të gjitha komunat është problem i njëjtë. Në disa komuna paguhen në mënyrë klandestine , pa bazë për kompensim të anëtarëve të komitetit që janë jashtë kuvendit. Pagesa të tilla nesër mund të jenë të gjetura të auditorit prandaj nuk ja preferoj ekzekutivit ta bëjë.

z. Zenun Elezaj, kryetar: Në lidhje me mos përgjigjen e drejtorëve, them se një herë edhe mund të ndodhë por arroganca e tyre nuk und të lejohet prandaj ju kisha lutë që të më shkruani mua.

z. Enver Berisha, drejtor: Mendoj që nuk ishte gjithçka qa u fol shumë korrekte sepse unë disa herë ju kam prit dhe kemi biseduar në zyre. Ne i kemi dërguar të gjitha listat për pagesë vazhdimisht por nuk jemi ne që i detyrojmë që të realizojnë pagesën. Ne i kemi bërë të gjitha angazhimet e duhura. Tek Kërkesa e dytë, unë asnjë shkresë- ftesë nuk e kam deri sot për pjesëmarrje në mbledhje të komitetit.

Znj. Menduhie Duraku- Tirana: Përshëndetje. Kam një pyetje për drejtorin e shërbimeve publike. Pse nuk është bërë komplet ndriçimi në rrugën "Shaban Sadiku" në lagjen mbi hekurudhë?

z. Qendrim Millaku, drejtor i ShPE: Ne kemi bërë investime në atë lagje aq sa kemi pasur buxhet, do të vazhdojmë vitin tjetër gjithsesi.

Znj. Besiana Gashi: A mundem që të ja dëshmoj drejtorit të financave se kur është ftuar të marr pjesë në mbledhje.

z. Tunë Dedaj: Kam dy pyetje. Për drejtorin e shëndetësisë shprehu shqetësim se nëse gjarpri e kafshon një qytetar të Klinës nuk ka serum kundër helmimit. Nuk kish as në Pejë e asnjë komunë. Kam një kërkesë që kuvendi të ndaj një pjesë të mjeteve dhe të sigurohet serumi. Për shërbimet publike kam një shqetësim tjetër sa i përket gjendjes në Hidrodrin, unë personalisht deh shumë qytetarë nuk janë të kënaqur sepse për ndërrimin e një tubi atyre ju duhen 5 orë punë ndërkohë që ajo punë në kushte normale bëhet për një orë.

z. Agron Bacaq, drejtor i Shëndetësisë: Serumi kundër helmimit të gjarprit ndodhet në spitale rajonale dhe gjendet në doza të pakta. Nëse lejohet ne do ta blejmë e kemi edhe lejen e kryetarit që të blejmë çdo ilaç që ju duhet qytetarëve por duhet shikohet ligji a na lejon.

z. Qendrim Millaku, drejtor i SHPE: Ndoshta është kohë e shkurt një orë sepse ndërprerja e ujit, lidhja e gypit dhe lëshimi i serishëm i ujit merr kohë.

z. Zafer Gashi: Kam pyetje të shkurtër për kryetarin, drejtorin e shëndetësisë dhe drejtorin e urbanizimit. Ka dalur në publikim se nuk ja keni lejuar bindën qytetarëve që kanë mbajtur protesta për fabrikën e çimentos. Për drejtorin e shëndetësisë: A punon rëntgeni sot dhe pse s` ka punuar një muaj rresht. Çfarë ndërtimesh janë duke u bërë brenda? Drejtorin e urbanizimit: A do të vazhdohet me dy arteriet tjera të fshatit me trotuar? Për drejtorin e shërbimeve publike: A mendoni se duhet të ketë intensitet me të madh dhe ekipe më të shumta për pastrimin e parqeve tani me ardhjen e mërgimtarëve tanë.

z. Zenun Elezaj, Kryetar: Me aq sa jam informuar, ka pas aplikacion dhe jemi takuar me drejtorin e i kam thënë se nuk duhet të ketë asnjë pengesë nga ekzekutivi. Drejtori i shërbime publike nëse ka me shtuar diçka sepse ka qenë në përgjegjësinë e tij.

z. Qendrim Millaku, drejtor i SHPE: Punëtorët për pastrim edhe pse ju ka skaduar kontrata janë duke e bërë maksimumin. Kërkesa për pëlqim për shfrytëzim të bines dhe hapësirës për këshillin grevist, personalisht jam marrë dhe brenda një periudhe 30 minutash nga bërja e kërkesës nuk ka qenë e mundur lëshimi i pëlqimit por në një deklaratë me shkrim e kam dhënë edhe unë nënshkrimin që gjithçka të shkoj mirë dhe pa pengesa. Pse ai ka thënë që ka pas pengesa nga ekzekutivi, le të mbetet në ndërgjyjen e tij por nuk është e vërtetë.

z. Agron Bacaq, drejtor i Shëndetësisë: Përgjigje në pyetjen e z. Gashi: Ka pas një defekt në pajisjen e rëntgenit afërsisht dy javë dhe është sanuar defekti. Afërsisht 60 filma në ditë bëhen në rëngën në QKMF dhe gjysma nga këta filma vijnë nga sektori privat. D.m.th. vjen tek ju pacienti në ordinancë private dhe mjeku i juaj i rekomandon

që të vijë në QKMF të bëjë rëntgenin pa pagesë. Mos me investuar dikush ankohet pse nuk po investohet , në QKMF momentalisht është duke u realizuar një projekt që mundëson qasjen më të lehtë të personave me aftësi të kufizuar.

Drejtori i Shëndetësisë z. Bacaj shpjegoj në detaje projektin që është duke u realizuar në QKMF dhe që është projekt i Bashkimit Evropian.

z. Enver Berisha, drejtor i Urbanizmit: I nderuar z. Gashi, projekti është një projekt që kap vlerën 295 mijë euro nga grandi i performancës- riasfaltimi i rrugëve lokale në Komunën e Klinës. Mendojmë që javën e ardhshme do të përfundoj projekti dhe punimet janë në kuadër të normave. Përveç kësaj e kemi vazhduar një projekt me kërkesë të qytetarëve në dy lagje në Sferkë. Projektet do të vazhdojnë gjithsesi në Sferkë kur ne ti kemi mundësitë buxhetore.

z. Zafer Gashi, kërkoj përsëri fjalën duke thënë se në QKMF nuk punon rëntgeni dhe se janë vjedhë disa pjesë nga shtëpiza kompjuterike. Ndërsa drejtori i Shëndetësisë kërkoj nga Zafer Gashi që ti thotë atij që e ka informuar të i jep informacione më të sakta. Z. Bacaj sqaroi që është vjedhë një pjesë e një kompjuteri që ka qenë jashtë funksioni dhe për këtë është njoftuar policia nga vet drejtori.

Debati në mes të drejtorit të Shëndetësisë dhe z. Zafer Gashi vazhdoi tutje me ndërhyrje të njeri tjetrit në fjalë (është komunikim interaktiv).

z. Enver Gashi: Përshëndetje. Kam një pyetje për drejtorin e shërbimeve publike. Ujësjiellësi në Sferkë nuk është funksional, pse nuk ka ujë në Sferkë?

z. Qendrim Millaku, drejtor i SHPE: E di që ka ndërprerje të ujit dhe energjisë elektrike të herë pas herë për shkak të nxehtësisë së madhe por që nuk ka fare nuk e kam këtë informatë nga Hidrodrini.

Znj. Lirie Gashi: Në vitin e ri shkollor a do të kenë nxënësit uniforma sipas rregullores?

z. Qemajl Sejdiu, drejtor i DKA: Faleminderit. Në diskutim me drejtor dhe menaxher të shkollave gjithsesi nëse është e nevojshme pse jo.

z. Asdren Ramadani: Pyetje për z. Millaku. Kur do të rregullohet ndriçimi në shëtitoren e lumit "Klina" .

z. Qendrim Millaku, drejtor i SHPE: Është shpallë për herë të dytë tenderi për një projekt të Komisionit Evropian. Janë në pritje të vlerësimit të ofertave pasi që ata i udhëheqin të gjitha procedurat.

z. Zenun Elezaj, kryetar: Ne i kemi riparuar dritat në parkun në fjalë disa herë. Nuk po mundemi që të i ndërrojmë dritat përsëri sepse do ta kenë fatin e njëjtë sikurse në të kaluarën prandaj kemi vendosë që ta rrisim lartësinë e dritave, besoi që do të kenë qëndrueshmëri më të madhe.

z. Armend Beqiri: Bashkësia lokale në Grabanicë ka më shumë se 15 vite që nuk është e lidhur në ujësjiellës. A ka ndonjë projekt që do ta bëjë të mundur lidhjen e kësaj BL në

rrjetin rajonal? Pyetja e dytë: Ka qenë projekti i kanalit të ujitjes në Grabanicë por nuk ka përfunduar akoma. Rendimenti pa ujitje në Grabanicë do të jetë zero. Në cilën fazë është ky projekt, kur pritet që të kryhet?

z. Qendrim Millaku, drejtor i SHPE: Bashkërisht edhe me CDI jemi në finalizimin e projektit në disa fshatra dhe posa të përfundoj ky projekt do të nisim në të gjitha fshatrat e tjera ku mungon rrjeti i ujësjellësit.

z. Lorenc Marleku, drejtor i Bujqësisë: Përshëndetje. Sa i përket kanalit të ujitjes ne vazhdimisht kemi punuar. Do të punojmë edhe në Grabanicë edhe në të gjitha vendet ku do ta kemi mundësinë. I di telashet në Grabanicë , kemi pasur vërshime që kanë krijuar dëme aty por që do ti rregullojmë.

Kryesuesi në përfundim të pikës Pyetje dhe përgjigje, falënderoi të gjithë për pjesëmarrje dhe ju uroj gjithashtu pushime të këndshme.

Procesmbajtës:

Skënder Behramaj



Kryesuesi:

Fadil Gashi

